VENDIM
Nr.7, datë 15.2.2007

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa "dh", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me të gjitha ndryshimet, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.2.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga KESH sh.a. për licencimin në aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga KESH sh.a. për licencimin e aktivitetit të importit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për shqyrtimin e kësaj kërkese.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta